



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë-Albania, Tel.04 2512-67

Nr. 208 Prot.

Tiranë, më 02/02/2012

Lënda: Për kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të KLSH.

Zj. Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

TIRANË

E nderuaru tj. Kryetare,

Më lejoni t'ju bëj me dije se auditimi i fundit i llogarive të KLSH nga ekspertët e caktuar nga Kuvendi është kryer në muajt janar-prill të vitit 2001, mbi 10 vjet më parë, ndërkohë që në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, neni 3, paragrafi i tretë, përcaktohet:

"KLSH duhet çdo vit të përgatisë llogaritë e tij në përputhje me ligjin për buxhetin. Llogaritë e tij kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe raporton te ky".

Cilësojmë se, çështja e kontrollit të llogarive vjetore të KLSH është trajtuar dhe në Kuvendin e Shqipërisë, mjafton të citoj rezolutën e Kuvendit me nr. 1250 prot., datë 5.5.2010 "Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2009", ku ndër objektivat e përcaktuara nga Kuvendi për vitin 2010, renditet dhe objektivi "Realizimi i detyrimit ligjor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të KLSH".

Standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI, praktikat më të mira të institucioneve të auditimit të lartë dhe rekomandimet e SIGMA të paraqitur në raportet e vlerësimit të veprimtarisë të KLSH të viteve 2008, 2009 dhe 2010, e kërkojnë këtë.

Në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor të sipërcituar dhe kërkesave tona për të rritur transparencën e KLSH, kërkoj angazhimin dhe mbështetjen Tuaj për auditimin sa më parë të llogarive të KLSH, për periudhën 2002-2011.

KRYETARI

Bujar LESKAJ

